

SHENIMET E PEDAGOGUT

TEMA 2. ANALIZA E PASQYRES SE TE ARDHURAVE DHE BILANCIT

A. PASQYRA E TE ARDHURAVE

Pasqyra e te ardhurave pergatitet duke perdorur kontabilitetit rrjedhes , ne te cilen te ardhurat/shpenzimet njihen vetem gjate periudhes qe te mirat dhe sherbimet sigurohen ne rastin e te ardhurave, dhe ndodhin ne rastin e shpenzimeve, pavarshisht se kur jane arketuar /paguar parate. Flukset e parase mund te levizin perpara, gjate ose pasi te ardhurat ose shpenzimet jane njohur ne kontabilitet. Diferenca ne kohe midis procesit te njohjes se te ardhures dhe levizjes se fluksit te krijon llogari aktive ose llogari detyrimesh. Rikujtoni trajtimet e bera ne temen dy mbi kontabilitetit rrjedhes.

Formati i Pasqyres se te Ardhurave.

Per te analizuar pasqyren e te ardhurave duhet te njohim mire formen ne te cilen paraqitet ajo :Formatet e paraqitjes se pasqyres se te ardhurave jane dy:

- Pasqyra me nje hap
- Pasqyra me shume hapa

Pasqyra e te ardhurave me nje hap paraqet gjithe te ardhurat ne nje vije nga te cilat zbret shpenzimet duke perftuar keshtu fitimin neto. Ne kete pasqyre eshte e veshtire te dallohen te ardhurat dhe shpenzimet qe vijne si rezultat aktiviteteve operacionle te vazhdueshme nga te ardhurat dhe shpenzimet qe vijne si rezultat i aktivitetetve jo operacionale . Ne kete format te pasqyres se te ardhurave nuk paraqitet fitimi per aksion.

Pasqyra me shume hapa eshte formati me i perdorur i paraqitjes se pasqyres se te ardhurave dhe karakteristikat e saj jane :

- Informacioni prezantohet ne disa grupe kryesore ne pasqyre.
- Ne pasqyre dallon aktivitetin operacional nga aktiviteti jo operacional.
- Rezultatet qe vijne nga aktivitetet e vazhdueshme jane treguar vecmas rezutateve qe vijne nga aktivitetet jo te vazhdueshme
- Efektet e tatimit po ashtu prezantohen vecmas.
- Shenzimet e tatimit mbi fitimin paraqiten vecmas.

Nuk ka nje rregull te percaktuar saktesisht neper standartet kotabel i cili te kerkoje qe pasqyra e te ardhurave te bazohet ne nje format te vecante. Megjithese formatet mund te ndryshojne neper firma te ndryshme, me poshte jepet nje percaktim i pergjithshem i nje pasqyre me shume hapa. Zerat e shenuara me nje tonalitet me te zi jane klasifikuar si komponentet e fitimit neto:

Formati i Paqyrave te te Ardhurave

SHENIMET E PEDAGOGUT

- Te ardhura nga shitja e te mirave dhe sherbimeve
- Shpenzime operative
Fitimi operacional
- + Te ardhura te tjera
Fitimi para interesave dhe taksave nga aktivitetet e vazhdueshme e vazhdueshme (EBIT)
- Kostot financiare (INTERESAT)

- +/- Te ardhura /shpenzime te pazakonshme ose jo frekvente
Fitimi para taksave nga aktivitetet e vazhdueshme (EBT)
- Tatimi mbi fitimin
Fitime neto nga aktivitetet e vazhdueshme
- +/- Fitimi / humbje nga operacionet e nderprera (raportuar neto nga taksat)
- +/- Fitimi / humbje nga ngjarje te jashte zakonshme te jashtezakonshme (raportuar neto nga taksat)
- +/- Fitimi humbja nga llogaritje e efektit kumulativ i ndryshimeve ne metodat kontabile (raportuar neto nga taksat)
- Fitimi Neto (EAT)

Formati i paraqitur me siper i pasqyres te ardhurave bazohen te ndarjen e aktiviteteteve te vazhdueshme dhe jo te vazhdueshme.

Aktivitetet e vazhdueshme jane te gjitha ato aktivitete te cilat ndodhin ne menyre te vazhdueshme ose perseriten ne cdo periudhe kontablile .

Brenda aktiviteteteve te vazhdueshme eshte nje nenbashkesi ajo e aktiviteteteve operacionale, te cilat jane aktivitetet qe lidhen direkt me qellimin kryesor te biznesit, pra me prodhimin dhe ofrimin e te mirave dhe shpenzimeve.

Te tilla mund te jene, shija e te mirave dhe sherbimeve qe prodhon kompania kostot qe lidhen me prodhimin e ketyre te mirave, shpenzimet e marketingut, etj.

Pjesa tjeter e aktiviteteteve te vazhdueshme nuk jane operacionale, cka do te thote qe nuk lidhen ne menyre direkte me qellimin kryesor te biznesit. Edhe pse ato nuk jane operacionale ato jane te vazhdueshme pasi ndodhin ne cdo periudhe kontabel. Shembuj te aktiviteteteve te vazhdueshme por jo operacionale jane tatimet, interesat, te ardhurat te tjera etj.

Ndersa aktivitetet jo te vazhdueshme jane ato kativite qe ndodhin nje here ne kohe, dhe nuk perseritet periudhe pas periudhe.Duke pasur parasysh kete ndarje komponentet e fitimit neto mund te pershkruhen ne menytrat e meposhtme.

Fitimi nga aktivitetet e vazhdueshme operacionale perfshin te ardhura nga aktivitetet e vazhdueshme operacionale te firmes duke zbritur kostot dhe shpenzimet e kryera per te gjeneruar keto te ardhura. Ky fitim eshte i pavarur nga struktura e kapitalit te kompanise sepse nuk perfshijne shpenzimet e interesit. Shumica e pasqyrave te te ardhurat nga shitjet do te zbrisnim vetem kostot e produktete ve te shitura do te gjeneronim ate qe ne kontabilitetitn e kostot dhe drejtimi do ta gjeni me emertimit fitimi bruto.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Fitimi nga aktivitetet e vazhdueshme perpara interesit dhe taksave perfshin te ardhura te tjera te zakonshme qe rezultojne nga aktivitetet e tjera, duke perfshire te ardhura nga investimet te ardhura nga komisionet bankare etj.

Fitimi nga aktivitetet e vazhdueshme para taksave perfshijne perballimin e kostove financiare, si shpenzime interesi te shkaktuara nga borxhi i perdorur nga kompania si burim financimi.

Fitimi nga operacionet e vazhdueshme perfshin ndikimin e taksave.

Fitimi neto perfshin gjithashtu edhe fitimet dhe humbjet nga aktivitetet jo te zakonshme ne te cilat perfshihen te nderprera, aktivitetet jashtezakonshme dhe efekti kumulativ i ndryshimeve ne metodat kontabile. Keto rregullime do te diskutohen ne menyre me te detajuar me poshte.

A.1. Aktivitetet jo te vazhdueshme

✓ Zerat e jashtezakonshem

Zerat e jashtezakonshem jane ngjarje qe jane edhe te pazakonta edhe jo te shpeshta ne ndodhje dhe materiale ne natyre. Shembuj te tyre perfshijne:

- Humbje nga shpronnesimi i mjeteve.
- Fitim ose humbje nga kthimi i hershem i borxhit.

Zerat e jashtezakonshem raportohen neto nga taksat dhe pas fitimit neto nga operacionet e vazhdueshme.

Implikimi analitik: Megjithese zerat e jashtezakonshem nuk ndikojne ne fitimin neto nga operacionet e vazhdueshme, nje analist duhet ti rishikojte ato per te percaktuar nese disa pjese te tyre duhet te perfshihen ne parashikimin e fitimit neto ne te ardhmen. Disa kompani duken te jene te prirura ndaj aksidenteve (rastesive) dhe kane humbje te jashtezakonshme cdo vit. Eshte e rendeshme qe te sqarojme kete ndryshimin midis zerave te jashtezakonshem dhe zerave te pazakonte te shpeshte.

✓ Zerat e pazakonte ose jo te shpeshte

Perkufizimi i ketyre zerave duket qe nga titulli—keto ngjarje ndodhin ose ne menyre te pazakonte ose jo te shpeshte, po jo njeheresh edhe te pazakonte edhe jo te shpeshte, sic eshte rasti i ngjarjeve te jashte zakonshme. Shembuj te zerave te pazakonte ose jo te shpeshte perfshijne:

- Fitime ose humbje operacionale qe vijne si rrjedhim i heqjes/shitjes e nje segmenti te nje biznesi (kostot e mbylljes se fabrikes etj.)
- Fitime ose humbje nga shitja e aktiveve ose investime ne kompani te tjera.
- Provigjone per rregullime mjedisore.

SHENIMET E PEDAGOGUT

- Demtime te asetëve (heqje nga bilanci ose zvogelim i vlerës së tyre për shkak të demtimit) dhe kosto ristrukturimi.

Zerat e pazakonte ose jo të shpeshtë raportohen për fitimin neto nga operacionet e vazhdueshme.

Implikimi analitik: Meqenëse zerat e pazakonte ose jo të shpeshtë ndikojnë në fitimin neto nga operacionet e vazhdueshme, një analist mund të dojë të rishikojë ato për të përcaktuar nëse disa pjesë duhet të përfshihen kur parashikohet fitimi në të ardhmen. Për më tepër, shpesh manaxhimi i riklasifikon këto zera duke i përfshirë në të ardhurat operacionale (në rast të të ardhurave), prandaj një analist duhet të përpiktë të gjejë këto zera dhe të segmentojë ato për të gjetur ndikimin e tyre në fitimin neto nga aktivitetet e vazhdueshme.

✓ **Operacionet e Nderprera**

Një operacion i nderprerë konsiderohet një segment i biznesit që menaxhimi i firmës ka vendosur të heqë dorë ose është duke hequr dorë në vitin aktual. Për të konsideruar si një operacion i nderprerë, pjesa e biznesit nga e cila do të hiqet dorë duhet të jetë fizikisht dhe funksionalisht e vecuar nga pjesët e tjera të firmës. Për të kete aktivitetet e veta, aktivitetet operative të veta si dhe aktivitetet investuese dhe financuese të vecanta.

Data kur kompania zhvillon një plan për heqjen e një segmenti quhet *data vlerësimit ose e matjes* dhe koha ndërmjet datës së vlerësimit dhe datës së heqjes dorë quhet *periudha e shfazimit*. Fitimi ose humbja nga operacionet e nderprera raportohet vecmas. Çdo fitim i pritur nga kjo shitje nuk raportohet derisa shitja të përfundohet. Fitimet ose humbjet nga operacionet e nderprera raportohen neto nga taksat pas të ardhurës neto nga aktivitetet e vazhdueshme.

Implikimi analitik: Analiza është e drejtperdrejtë. Operacionet e nderprera nuk ndikojnë në fitimet neto nga operacionet e vazhdueshme, pasi fitimet ose humbjet që vijnë nga këto operacione janë jo të vazhdueshme dhe nuk priten të perseriten nga një periudhë deri në një periudhë tjetër kontabile.

✓ **Ndryshimet në Metodën Kontabile**

Çdo ndikim në fitimet e periudhave të mëparshme që vjen nga një ndryshim në metodën kontabile raportohet neto nga taksat. Në përgjithësi, pasqyrat financiare të viteve të mëparshme kanë nevojë të rregullohen, nëse ndryshimi përfshin një nga sa vijon:

- Ndryshimi nga metoda kontabile LIFO në një tjetër.
- Ndryshimi nga amortizimi i pershpëjtuar tek amortizimi linear.
- Ndryshimi nga shpenzimi i kostove tek kapitalizimi i tyre.

Ndikimi nga ndryshimet në metodën kontabile raportohet neto nga taksat pas fitimit neto nga operacionet e vazhdueshme.

Implikimi analitik: Çdo ndryshim i fitimeve në periudhat e mëparshme, që rezultojnë nga një ndryshim në metodën kontabile, nuk ndikon në fitimin neto nga operacionet e vazhdueshme. Ndryshimet kontabile në mënyrë tipike nuk ndikojnë në fluksin e

SHENIMET E PEDAGOGUT

parase. Nje analist duhet te rishikoje cdo ndryshim kontabel per te percaktuar nese ka ndikuar ne rezultatet operacionale te ardhshme.

*Shenim:*Nje ndryshim ne parimin e perdorur duhet te dallohet nga nje ndryshim ne menyren e llogaritjes apo te vleresimit. Per shembull nje dryshim i parim eshte

Shembull 1

Kompania Gilbert blen nje makineri ne 1/1/2002. Kosto e makinerise eshte \$100,000. Jetegjatesia eshte 4 vjet. Nuk ka vlere te mbetur. Norma e tatimit eshte 30%.

Kompania perdor metoden e amortizimit te pershpejtuar per 2002 dhe 2003 dhe ndryshon metoden e amortizimit ne 2004 (1/1/2004.)

Prezantoni ndryshimin ne metoden e kontabilizimit .

Viti	Amortizimi i pershpejtuar	Amortizim linear	Diferenca
2002	\$50,000	\$25,000	\$25,000
2003	\$25,000	\$25,000	\$ -0-

Diferenca ne \$25,000, prezanton rritje te fitimit neto .

Efekt i kumulativ i aplikimit retroaktiv (aplikim retroaktiv do te thote qe edhe pse ndryshimi ka ndodhur ne 2004 ne do te supozojme qe kemi perdorur amoritzimin linear qe ne 2003) pas taksave eshte 25000 $(1 - 0.3) = \mathbf{\$17,500}$

Ndryshimet ne Vleresimet Kontabel, jane dryshimet qe ndodhin ne parametrat e llogaritjes kontable. Vleresimi kontabel mund te ndryshoje nese ka ndodhur dicka e re, eshte fituar me shume eksperience ose kur zoterohet me shume informacion.Ndryshimet ne vleresimet kontabel kontabilizohen per periudhen e ndryshimit dhe ne periudhat e ardhshme.

Ne 1/1/2004, kompania Gilbert (shiko shembullin e meparshem) rivleresoi se jetegjatesia e makinerise do te jete edhe per 3 vite te tjera (2004, 2005 and 2006). Vlera e mbetur eshte vleresuar te jete \$5,000.**Ky ndryshim perfshin ndryshime ne vleresim.**

Vlera kontabile (1/1/2004):	\$50,000
minus: Vlera e mbetur	(\$5,000)

Kostoja e rivleresuar e amortizimit :	\$45,000
Kostoja e rivleresuar e amortizimit :	\$45,000
Jetegjatesia e mbetur :	3 vjet
Amortizimi vjetor :	\$15,000
Vitet 2004, 2005dhe 2006)	

SHENIMET E PEDAGOGUT

Shenim: Ndryshimi ne jetegjatesine dhe vleren e mbetur nuk ndikon ne periudhat e meparshme, pra nuk ka efekt rektroaktiv.

A.2. Njohja e te Ardhurave

Te Ardhuat jane rritja e benefiteve gjate nje periudhe kontabile, te cilat rezultojne ne rritjen e kapitalit te vet, vec rasteve te rritjes se kapitalit si rrjedhim i derdhjeve nga vete aksioneret.

Qe njohja e te ardhurave te jete e arsyshme dhe e drejte duhen te kene potesuar keto kushte:

✓ ***Te kete perfunduar procesi i perfitimit te te ardhures***

Qe ky kusht te konsiderohet i plotesuar duhet te permbushet sa me poshte:

- kete siguruar pothuajse te gjitha te mirat ose sherbimet per te cilat do te paguhet dhe
- kostoja e pritshme e sigurimit te mirave dhe sherbimeve duhet te jete e matshme.

Megjithese ne shumicen e rasteve keto kosto jane te matshme, ka raste kur ka kosto te mundshme te sigurimit te shitjeve te cilat nuk jane te matshme, keshtu qe ne keto kushte njohja e te ardhures shtyhet derisa te gjitha kostot te behet e matshme. Per projekte afatgjata kur ofrimi i te mirave dhe shpenzimeve perfshijne me shume se disa periudha kontabile, pjesa e te ardhurave qe njhet ne cdo perjudhe mund te behet ne menyren e meposhteme:

✓ **Sigurimi i Pageses**

Kompania duhet te jete ne gjendje te vleresoje mundesine e arketimit te ardhurave. Duke pasur parasysh menyren sesi plotesohen keto kushte me poshte do te trajtojme dhe menytrat e ndryshme te njohjes se te ardhurave ne kontabilitet.

3. Parimi i Perputhjes

Parimi i perputhjes kerkon qe te ardhurat dhe shpenzimet e kryera per te gjeneruar keto te ardhura duhet te njihen brenda te njejtes periudhe kontabile.

A.4. Metodatat e Njohjes se te Ardhurave

Ka pese metoda per te njohur te ardhurat, te cilat perdoren rast pas rasti ne varesi te plotesimit te kushteve te njohjes se te ardhures.

1. Metoda e Bazuar mbi Shitjet

Sipas *metodes se bazuar mbi shitjet* te mirat ose sherbimet sigurohen menjehere kur behet shitja. Pra shijta kryhet ne nje afat te shkurter. Shitja behet me para ne dore ose me kredi (pagese e mevonshme)ndaj nje klienti me nje probabilitet te larte

SHENIMET E PEDAGOGUT

pagimi. Ne qofte se parate merren perpara se te sigurohen te mirat ose sherbimet, e ardhura nuk njihet derisa te fitohet (meritohet). Shembuj mund te perfshijne:

- E ardhura nga shitja e revistes nuk njihet derisa ajo te jete dorezuar.
- Taksat e kartes se kreditit te marra ne avance nuk jane te ardhura derisa te perfundoje periudha te ciles ato i perkasin,
- Para te marra nga dhenia me qera e pajisjeve e bazuar ne perdorimin nuk eshte e ardhur deri sa pajisjet te perdoren.

Ne secilin prej ketyre rasteve, e ardhura nuk njihet derisa te jete fituar dhe te jete siguruar mbledhja e parave. Kostoja e te mirave ose sherbimeve do te njihet si shpenzim vetem kur te regjistrohet e ardhura e saj korresponduese.

2. Metoda e Perqindjes se Kompletimit

Metoda e perqindjes se kompletimit perdoret per projekte afatgjata kur ka nje kontrate dhe ka vleresime te besueshme te te ardhurave qe do te sjelle projekti, kostove te tij si dhe nje afat te percaktuar te perfundimit te kontrates. Ne baze te kesaj metode te ardhurat dhe shpenzimet perkatese njihen ne kontabilitet ne propocion me perqindjen e punes se perfunduar. Ka dy menyra qe mund te perdoren per te matur pjesen e perfunduar te punes:

- Nje vleresim inxhinierik
- Raporti i shpenzimeve tanime te kryera kundrjet shpenzimeve totale. Kjo metode perdoret lehetesisht kur njihen me siguri kostot totale por absolutisht mund te perdoret edhe kur vleresimi i kostove totale nund te ndryshoje.

Shembull:

Nje kompani po nderton nje stadium per \$100 milion, shume kjo qe e do te arketohet ne pagesa te barabarta te kryera nga porositesi per kater vjet. Nje vleresim i besueshem i kostos totale te kesaj kontrate (projekti) eshte \$80 milion.

Pjesa A: Gjate vitit te pare te ndertimit shpenzimet e bera(kostot e kryera) ishin \$16 milion. Sa te ardhura dhe fitim do te njihen vitin e pare?

Pjesa B: Gjate vitit te dyte shpenzimet e bera ishin \$20 milion. Per me teper, kompania ka rishikuar vleresimin e saj te kostos totale ne \$90 milion. Sa te ardhura dhe fitim do te njihen ne vitin e dyte?

Pergjigje:

Pjesa A:

E _____

Pjesa B:

3. Metoda e Permbushjes (Kompletimit) te Kontrates

Metoda e Permbushjes (kompletimit) te Kontrates perdoret per projekte afatgjata kur nuk ka nje afat te caktuar te kontrates ose vleresimet e te ardhurave ose kostove jane te paqendrueshme. Ne kete rast duke qene se pasiguria eshte e larte nuk njohim as te ardhura as shpenzime derisa projekti te jete perfunduar.

Shembull:

Nje kompani po nderton nje stadium per \$100 milion, shume kjo qe e do te arketohet ne pagesa te barabarta te kryera nga porositesi per kater vjet. Megjithate, nuk mund te behet asnje vleresim i besueshem per koston e saj totale. Kompania shpenzoi \$16 milion ne vitin e pare. Sa te ardhura dhe shpenzime do te njihen ne vitin e pare?

Pergjigje:

Ne kete rast nuk mund te vlersojme sesa perqind te te ardhures totale kemi perfituar, sepse nuk njohim me siguri koston totale. Ne kete rast duhet te perdorim metoden e se permbushjes se kontrates, e cila na con ne perfundimin qe nuk do te njohim asnje te ardhur apo shpenzim deri vitin e fundit te permushjes se kontrates.

4. Shitjet me Keste

Metoda e *shitjeve me keste* perdoret kur nuk ka asnje menyre per te vleresuar mundesine e mbledhjes se te ardhurave nga shitja, por kostoja e te mirave dhe sherbimeve eshte e njohur. Ne kete rast do te njohim te ardhurat ne propocion me mbledhjen e parave. Pra nese vini re njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve ne kontabilitet behet duke perbushur te gjitha kushtet e njohjes te tyre. Nese nje nga keto kushte nuk plotesohet ose jemi te pasigurt se mund te plotesohet, njohja e te ardhurave shtyhet deri ne plotesimin e te gjitha kushteve ose behet ne propocion me plotesimin e te gjitha kushteve.

Shembull:

SHENIMET E PEDAGOGUT

Kompania A i shiti kompanise B per \$300,000 disa aktive te saj me nje vlere kontabile \$100,000 me kushtin kontraktual qe pagesat do te vareshin nga fitimet qe do te siguronte kompania B. Kushti kontraktual ishte qe B nuk do ti duhet te paguaje asnje dollar me shume sesa fitimi i saj bruto. Ne vitin e pare fitimi bruto i kompanise B ishte \$120,000, dhe ajo ia pagoi kete shume kompanise A. Ne vitin e dyte fitimi bruto ishte \$90,000—shume te cilen ajo serish ia pagoi kompanise A. Sa te ardhura dhe fitim njohu kompania A ne secilin nga dy vitet e para?

Pergjigje:

Ne vitin e pare kompania A do te regjistronte \$120,000 te ardhura dhe shpenzimet do te ishin:

$$\text{Fitimi I vitit te dyte} = \$120,000 - \$40,000 = \$80,000$$

Ne vitin e dyte kompania A do te regjistronte \$90,000 te ardhura dhe shpenzimet do te ishin:

$$\text{Fitimi I vitit te dyte} = \$90,000 - \$30,000 = \$60,000$$

5. Metoda e rikuperimit te gjithe kostove

Metoda e rikuperimit te gjithe kostove perdoret kur nuk dihen kostos e sigurimit te te mirave apo sherbimeve. Sipas kesaj metode te ardhurat nuk njihen deri sa te gjitha kostos te jene kryer. Cdo njohje e te ardhurave ne avance do te thyente parimin e pershatjes pasi kompania nuk do te mund te regjistronte shpenzimet per realizimin e ketyre te ardhurave pasi nuk i vlereson dot me saktesi.

Shembull:

Kompania A i shiti kompanise B disa aktive te saj (me nje vlere aktuale kontabile \$100,000) per \$300,000 me pagese ne varesi te fitimeve te kompanise B. Kompania B nuk do te paguante asnje dollar me teper se fitimi i saj bruto. Kompania A ra dakort te riparoje makinerite per tre vitet e ardhshme, pa pagese nga kompania B, por nuk eshte e sigurte se sa do te jete kostoja e sherbimit.

Ne vitin e pare fitimi bruto i kompanise B ishte \$120,000 dhe ajo ia pagoi kete shume kompanise A. Ne vitin e dyte fitimi bruto ishte \$90,000—shume te cilen ajo serish ia pagoi kompanise A. Ne vitin e trete fitimi bruto ishte \$180,000 dhe ajo i pagoi kompanise A \$90,000 te mbetura si detyrim ndaj saj. Kostoja e sherbimit per secilin nga te tre vitet ishte \$20,000, \$30,000 dhe \$40,000. Sa te ardhura dhe fitim njohu kompania A ne secilin nga tre vitet e para?

SHENIMET E PEDAGOGUT

Pergjigje:

Per shkak te pasigurise se koston se saj te sherbimit, kompania A nuk do te njihte asnje te ardhur apo shpenzim derisa te gjitha shpenzimet te kryheshin , prandaj per dy vitet e para e ardhura dhe fitimi ishin 0. Ne vitin e fundit ajo regjistroi \$300,000 te ardhura. Shpenzimet do te jene sa vlera kontabile e makinerive (\$100,000) shpenzimet e mirembajtjes per te tre vitet, \$20,000 plus \$30,000 plus \$40,000 (gjithsej \$90,000). Atehere e fitimi total ne vitin e trete eshte \$110,000.

A.5. Implikimet Analitike

Kur krahasojne firmat analistet duhet te jene ne dijeni te metodave te ndryshme te njohjes se te ardhurave. Nje analist duhet te jete ne djeni te ketyre metodave pasi sic do te diskutojme me poshte ato kane efekte te ndryshme te pasqyrat financiare. Ne te njejten kohe zgjedhja e metodes se njohjes se te ardhurave eshte nje zgjedhjen indirekte te menaxhimit sepse ne fund te fundit eshte ky i fundit i cili harton dhe percakton shpesh kushtet e transaksioneve te shitjes se te mirave apo sherbimeve. Duke njohur efektet qe kane metodat e njohjes se te ardhures ne kontabilitet nje analist mund te investigoje dhe vlersoje zgjedhjet e bera nga menaxhimi si dhe cilesine e raportimit financiar.

- *Metoda e bazuar ne shitjet* eshte metoda me e perdorur dhe shumica e bizneseve i njej te ardhurat sipas kesaj metode. Metoda e bazuar nga shitjet eshte standarti baze me te cilin ne do ti krahasojme te gjitha metodat e tjera.
- *Metoda e perqindjes se kompletimit* eshte e perafert me metoden e bazuar ne shitjet dhe eshte nje zgjatim llogjik i kesaj te fundit per kontratat afatgjata.
- *Metoda e kompletimit te kontrates* eshte me konservative se sa metoda e perqindjes se kompletimit . Ne metoden kompletimit te kontrates te ardhurat njihen shume me prapa ne kohe ne krahasim me metoden e perqindjes se kompletimit. Gjithashtu fitimi neto gjate jetes se kontrates do te jete shume me i ndryshueshem nen metoden e kompletimit te kontrates sesa nen metoden e perqindjes se kompletimit. Nga kjo luhaje ne vlerat e fitimit neto gjate jetes se kontrates eshte e pamundur qe perfitueshmeria e projekteve afatgjata te matet duke perdorur pasqyren e te ardhurave—ne kete rast nje analist per matjen per fitueshmerise duhet te bazohet ne pasqyren e flukseve te parase (Cash flow), pasqyre e cila do te studiohet me vone gjate ketij kursi
- *Metoda e shitjes me keste* eshte e ngjashme me metoden e perqindjes se kompletimit nga menyra se si i njej te ardhurat neper faza. Megjithate ajo i njej te ardhurat me vone sesa ne metoden e bazuar mbi shitjet dhe per projektuar drejt perfitueshmerine e ardhshme te kompanise nje analist duhet te krahasoje pasqyren e fluksit te parase me pasqyren e te ardhurave.

SHENIMET E PEDAGOGUT

- *Metoda e rikuperimit te gjithë kostove* është e ngjashme me metoden e kompletimit se kontrates (ne te njejten menyre qe metoda e shitjes me keste është e ngjashme me metoden e perqindjes se kompletimit), metode ne te cilen te ardhurat dhe shpenzimet nuk njihet derisa te jene plotesuar te gjitha kushtet e njohjes se tyre . Nje analist duhet te bazohet ne pasqyren e flukseve te parase per te matur perfitueshmerine e shitjeve.

Ne qofte se *nje firme nje te ardhura perpara permbushjes se kushteve per njohjen e te ardhurave*, atehere rezultati qe do te kishim do te ishte efekte jo vetem ne pasqyren e te ardhurave por edhe ne ate te bilancit. Per shembull nese nje kompani do te regjistrote te ardhura te cilat nuk i ka fituar dhe qe nuk jane arketuar ne te njejten kohe atehere *aktivet afatshkurtra* te saj do te *zmadhoheshin fiktivisht* pasi do rriten e llogarite e arketueshme (te cilat do te rriteshin me vleren e njesite e quajtura fiktivisht te shitura * cmimin e tyre) si dhe do te kishim ulje te llogarise inventareve, me vleren e kostos se pordukteve qe konsiderohen te shitura. Pra vlera me te cilen rriten llogarite e arketushme është me larte se vlera me te cilen ulen llogaria inventare duke cuar keshtu ne rrite te aktiveve afat shkurta. Gjithashtu *fitimi i pashperndare* i saj do te *zmadhohej* nga fitimi neto i zmadhuar padrejtesisht nga njohja e pershpejtuar e te ardhurave.

3.1. Zgjedhja e Metodes se Pershtatshme te Njohjes se te Ardhurave

Zgjedhja se cila metode e njohjes duhet perdorur varet nga keto faktore: statusi i kompletimit te procesit te perfitimit te ardhurave, vlersimi i kostove dhe sigurimi i pageses.

<i>Procesi i kompletimit te perfitimit te te ardhures</i>	<i>Sigurimi i te ardhurave</i>	<i>Metoda e njohjes se te ardhurave</i>
I perfunduar	E sigurte	E bazuar mbi shitjet
I perfunduar	E pasigurte	Shitjet e me keste
I perfunduar me perafersi	E sigurte	Rikuperimi i kostos
I perfunduar me perafersi	E pasigurte	Rikuperimi i kostos
I paperfunduar dhe kostot mund te vleresohen	E sigurte	Perqindja e kompletimit
I paperfunduar dhe kostot mund te vleresohen	E pasigurte	Kompletimi i kontrates
I paperfunduar dhe kostot s'mund te vleresohen	E sigurte	Kompletimi i kontrates
I paperfunduar dhe kostot s'mund te vleresohen	E pasigurte	Kompletimi i kontrates

A.6. Manipulimi i te Ardhurave

SHENIMET E PEDAGOGUT

Nje dobesi e kontabilitetit rrjedhes eshte qe ai eshte subjekt i lirise se veprimi te manaxhimit dhe manaxhimi mund ta perdore kete liri veprimi per te manipuluar pasqyrat financiar sidomos pasqyren e te ardhurave. Ka dy elemente ku menaxhimi mund te perdore zgjedhjet e veta per te manipuluar pasqyren e te ardhurave—koha e ndodhjes se ngjarjes ekonomike dhe klasifikimet e te ardhurave. Manipulimet e fitimeve mund te klasifikohen ne kater kategori:

✓ **Klasifikimi i ngjarjeve te mira dhe ngjarjeve te keqija**

Ligji i famshem ekonomik i nje situate apo politike ai pushon se qenuri nje mates i vlefshem. Fitimi nga aktivitetet e vazhdueshme eshte treguesi qe perdoret jo vetem per te vlersuar performancen e tanishme por edhe per te parashikuar performancen e ardhshme. pra ai eshte pranuar gjeresisht si treguesi me i mire i fitimeve te ardhshme shume kompani mundohen ta manipulojne ate. Keshtu qe kompanite preferojne ti klasifikojne ngjarjet e mira si ngjarje te vazhdueshme duke i klasifikuar ato ne kategori qe do te shfaqen mbi vijen e fitimit neto nga operacionet e vazhdueshme Ndersa ngjarjet e keqija do te perpiqen ti klasifikojne si ngjarje jo te zakonshme (pra qe ndodhin vetem nje here ne kohe) duke i klasifikuar si kategori qe paraqiten nen vijen e fitimit neto nga operacionet e vazhdueshme (p.sh ne te ardhura nga operacione te nderprera ose zera te jashtezakonshem).

✓ **Stabilizimi i Fitimeve**

Duke qene qe analistet preferojne te shohin firma me fitime stabile, nga periudha ne periudhe, kompanite perpiqen te reduktojne fitimet ne periudhat e mira dhe i rrisin ato ne periudhat e veshtira, qe fitimet te duken me te qendrueshme nga sa do te ishin ne te vertete. Ka dy menyra per stabilizimin e fitimeve:

- **Stabilizimi nderkohor** ndodh kur nje kompani ose zgjedh kohen e njohjes se shpenzimeve ose zgjedh metoda kontabile qe i stabilizojne te ardhurat. Pra ne kohera te mira ekonomike zgjedh te njoh me shume shpenzime duke bere qe nje kohera te keqia ekonomike (me pak shitje te kete me pak shpenzime per te njohur) duke stabilizuar keshtu fitimet.
- **Stabilizimi me ane te klasifikimit** ndodh kur nje ze i caktuar raportohet ne nje kategori mbi apo nen vije (ne menyre qe te ndikoje ose jo sipas qellimit ne fitimin neto nga aktivitetet e vazhdueshme) duke arritur keshtu stabilizimin e fitimeve.

✓ **Big Bath Behavior**

Kur kompanite jane duke kaluar periudha te veshtira, ato perpiqen te marrin humbje shtese, duke i raportuar te gjitha lajmet e tyre te keqija ne te njejten kohe. Ne periudhat e krizave nder- ekonomike kjo eshte nje sjellje qe e zbatojne shume kompani. Kuptohet qe ne kohe krizash te medha investitoret nuk pret rezultate te mira nga kompanite. Investitoret jane te pergatitur shpirtorisht per humbjet.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Keshtu qe ne kohe humbjesh shume menaxhere, nxitojne te njohin edhe shpenzime te cilat mund ti perkasin perjudhave te ardhshme kontabile, duke bere qe te thellohet humbja ne perjudhen krize, por te paraqiten fitime te larta ne periudhat pasardhese.

✓ **Ndryshimet Kontabile**

Firmat do ti perdorin ndryshimet kontabile per manipuluar fitimet. Ato jane ndryshime nga norma, ndryshime ne shifra, ndryshime ne menyren sesi manaxhimi flet rreth gjerave, ndryshime qe cdo njeri i pranon (nese nuk ben pyetjet e nevojshme) sepse ato duken sikur kane kuptim. Ne fakt, nese ka nje mesim qe nuk duhet harruar , ai eshte “qe nese nje kompani ben nje ndryshim qe ngre nje pyetje, analistet duhet te kapen pas saj, ta shikojne mire dhe te sigurohen qe ata e kuptojne ate”. Ata duhet te percaktojne nese ndryshimi ka kuptim ne kontekstin e pergjithshem te biznesit, apo eshte thjesht nje manipulim i matesave te performances. Ne kete menyre analistet mund te sigurohen qe fuqite e matesave te performances nuk po ulen nga cilesia e ulet e inputeve te tyre. Disa nga keto ndryshime mund te jene p.sh. ndryshimi i metodës se inventarizimit, kapitalizimi kundrejt vendimeve te shpenzimeve, ose metodologjia e amortizimit.

A.7. Fitimi per Aksion

Fitimi per aksion eshte nje indikator shume i rendesishem per biznesin. Mdelet e bazuara ne treg per vlesimin e aksioneve bazohen gjeresisht ne fitimin per aksion. Nga vete emri, fitimi per aksion tregon sa para ka futur firma per cdo aksion qe ajo ka ne qarkullim. Fitimi per aksion duhet te paraqitet per cdo seksion te pasqyres se ardhurave.

Per te kuptuar llogaritjen e fitimit per akson duhet te kuptojme strukturen e kapitalit te kompanise. Stuktura e kapitalit tregon se cilat jane burimet afat gjate dhe financimit te kompanise. Me ane te struktures se kapitalit nje analist mund te percaktoje peshat specifike te financimit me ane te kapitalit te vet (ose te pronarit) dhe me ane te borxhit afat gjate. Burimet afat gjate te fiancimit sigurohen ne tregun e kapitalit duke emetuar letra me vlere qe zakonisht perbehen nga obligacionet ne rastin e borxhit dhe aksionet e zakonshme dhe preferenciale ne rastin kapitalit te vet.

Struktura financiare ndryshon nga struktura e kapitalit pasi ajo perfshin pervec burimeve afatgjate te financimit edhe burimet afatshkurtra te financimit . Pra praktikisht struktura financiare tregon peshat specifike te financimit nga burimet afatshkurtra , borxhit afat gjate dhe kapitalit.

Kemi :

- **Strukture te thjeshte te kapitalit** – kur struktura e kapitalit nuk permban letra me vlere te konvertueshme ne aksione te zakonshme.
- **Strukture komplekse te kapitalit** – kur struktura e kapitalit nuk permban letra me vlere te konvertueshme ne aksione te zakonshme, si obligacione te konvertueshme, aksione preferenciale te konvertueshme, opsione mbi aksionet e zakonshme.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Ne rastet e struktures se thjeshte te kapitalit llogaritet fitimi per aksion baze i cili paraqitet si raport i:

-
- Dividendet e aksioneve preferenciale zbriten nga fitimi neto, pasi EPS duhet ti referohet vetem fitimeve qe jane disponibel per aksioneret e zakonshem.
 - Mesatarja e ponderuar e aksioneve te zakonsheme qe jane ne qarkullim eshte numri i aksioneve ne qarkullim gjate vitit te ponderuara me pjesen e vitit qe ato kane qene ne qarkullim.

Fitimi per aksion i zvogeluar (Dilutive EPS).

Ne rastet e struktures komplekse te kapitalit llogaritet fitimi per aksion i zvogeluar i cili llogaritet si raport i:

EPS e zvogeluar reflekton fitimin me te vogel te mundshem per aksion.

A.8. Analiza e Pasqyres se te Ardhurave

Objekti kryesor i analizes se pasqyres se te ardhurave lidhet me vleresimin e performances se kompanise gjate nje periudhe kohe te caktuar **duke u krahasuar me performancen e vet historike si dhe me performancen e kompanive te tjera kryesisht te ngjashme me te.**

Ne kete pjese do te njihemi me metoden baze te analizes se pasqyres se te ardhurave, e cila eshte analiza e matjes se thjeshte. Kjo eshte nje nga teknikat me te thjeshta te analizes se pasqyres se te ardhurave e cila ndihmon analistin jo vetem te krahasoje pasqyren e te ardhurave ne kohe por edhe ta krahasoje ate me kompani te tjera.

Analiza e matjes se thjeshte kryhet duke llogaritur cdo ze te pasqyres se te ardhurave si perqindje me te ardhurat nga shitja. Analiza e matjes se thjeshte thjeshton, dhe mundeson:

- ❖ Krahasimin ne periudha te ndryshme kohe si dhe
- ❖ Krahasimin midis kompanive te madhesive te ndryshme

Tabela A Pasqyrat e te Ardhurave per Kompanite A, B, C

	A	B	C
Shitjet	10,000,000	10,000,000	2,000,000
Kosto e mallrave te shitura	3,000,000	7,500,000	600,000
<i>Fitimi Bruto</i>	<i>7,000,000</i>	<i>2,500,000</i>	<i>1,400,000</i>

SHENIMET E PEDAGOGUT

Shpenzimet administative	1,000,000	1,000,000	200,000
Shpenzimet e kerkimit & zhvillimit	2,000,000	-	400,000
Reklamat	2,000,000	-	400,000
Fitimi operativ	2,000,000	1,500,000	400,000

Duke u mbeshtetur vetem ne shirfat absolute te pasqyres se te ardhurave nje analist nuk mund ta analizoje dhe krahasoje performancen e kompanive, pasi kompanite mund te jene te permasave te ndryshme dhe mund te realizojne shifra afarizmi (te ardhura nga shitjet te dryshme . Kjo e ben te pamundur analizen e vlerave absolute

Tabela B Analiza e matjes se thjeshte per Pasqyren e te Ardhurave per Kompanite A, B, C

	A	B	C
Shitjet	100%	100%	100%
Kosto e mallrave te shitura	30%	75%	30%
Fitimi Bruto	70%	25%	70%
Shpenzimet administative	10%	10%	20%
Shpenzimet e kerkimit dhe zhvillimit	20%	0%	20%
Reklamat	20%	0%	20%
Fitimi operativ	20%	15%	20%

Duke bere analizen e matjes se thjeshte, pra duke shperhur cdo ze te pasqyres se te ardhurave si perqindje mbi shitjet analisti lehtesisht mund te vereje qe shpenzimet e shprehura si perqindje mbi shitjet si dhe fitimi operativ i shprehur si perqindje mbi shitjet ekzaktesisht njesoj per kompanine C dhe kompanine A. Gjithashtu mund te vihet re qe dhe pse ne terma absolut fitimi i realizuar nga kompania C eshte me i vogel se fitimi operativ i kompanise B, ne perqindje eshte me i larte, gje qe tregon qe per cdo 100 \$ shitje kompania C realizon 5 \$ fitim me shume se kompania B.

Tabela B tregon dhe ndryshimet ne strategjite e kompanive. Duke krahasuar **dy** kompanite A dhe B ,Kompania A raporton nje perqindje te fitimit bruto me te larte se kompania B.

Duke qene se te dy kompanite veprojne ne te njetjen industri, cilat mund te jene arsytet qe sjellin kete ndryshim?

Duke pasur parasysh limitimin ne te dhena ne kete shembull nje shpjegim i mundshem mund te gjendet duke analizuar ne menyre te shkallezuar keto pasqyra Me nje veshtrim te kujdesshem mund te veme re se Kompania A shpenzon shuma te konsiderushme ne kerkim dhe zhvillim dhe ne marketing. Shpenzimet ne kerkim dhe zhvillim cojne ne produkte te nje cilesie superiore, dhe me kosto me te ulet, gje qe ne kete rast vertetohet edhe nga kostot e produkteve te shitura qe ne rastin e kompanise A jane 30% dhe ne rastin e Kompanise B jane 75 %. Edhe shpenzimet e marketingut ndikojne ne permiresimin e marxhit Bruto (fitimi bruto/shitjet) pasi ato cojne ne nje njohje me te gjere te markes se produktit.

Kompania A shet nje produkt me superior teknologjikisht dhe me nje imazh me te mire te markes, gje qe mund te reflektohet direkt tek nje cimim me i larte.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Kompania B shet produkt me lire duke rezultuar ne nje marzh bruto shume te ultet, duke mos shpenzuar ne kerkim dhe marketing.

Ne praktike diferencat midis kompanive jane me te mprehta por koncepti ne pergjithsi eshte i njejte. Nje analist i cili shikon diferenca sinjifikante duhet qe te kerkoje dhe te kuptoje arsyet e diferencave ne menyre qe te percaktoje qarte implikimet e tyre ne performacat e ardhme te kompanise.

Analiza e raporteve financiare te pasqyres se te ardhurave

Te dhenat financiare konvertohen ne raporte per ti bere ato me te lehta per tu analizuar. Analiza e raporteve kryesore siguron nje veshtrim se si firma po performon krahasuar me vitet e tjera dhe si ajo po performon krahasuar me kompanite e tjera ne industrine e saj dhe ekonomine ne teresi. Megjithese ka me mijera raporte qe mund te llogariten, ka nje nenbashkesi relativisht te vogel ne te cilen nje analist duhet te fokusohet. Raportet qe llogariten nga pasqyra e te ardhurave jane kryesisht raporte te perfitueshmerise (kthimi) i cili eshte nje element i redesishem i performances.

Raportet e performances tregojne se sa mire manaxhimi po drejton biznesin. Ato mund te ndahen ne dy kategori: raporti i eficences se operimit dhe raporti i kthimit (perfitueshmerise) se operimit. Raportet e perfitueshmerise operative perfshijne marzhin e fitimit bruto, marzhin e fitimit operativ, marzhin e fitimit neto, kthimin nga kapitali total dhe kthimin nga kapitali i vet.

- a) *Marzhi i fitimit bruto* eshte raporti i fitimit bruto (shitjet minus kostoja e produkteve te shitura) me shitjet:

Marzhi i fitimit bruto tregon sa fitim bruto kompania realizon per cdo dollar shitje. Nje nivel i larte i ketij raporti eshte i deshirueshem edhe pse diferencat ne kete raport reflektohen prej diferencave ne strategjite e kompanise. Per shembull konsideroni nje kompani e cila ka zgjedhur si strategji te shese nje produkt te diferencuar (nje produkt i diferencuar nga emri i markes, cilesia, teknologjia superiore, ose mbrojta nga patentat). Nje kompani qe shet nje produkt te diferencuar e shet ate me cmime me te larta se produktet e tjera te ngjajshme. Por kompanite qe shesin produkte jo te diferencuara mund te kene marzh bruto me te larte ne vitet e para, kjo per arsyen e thjeshte se te krijosh produkte te diferencuara dhe te arrish te shesesh me cmime me te larta keto produkte do kohe. Ndodh shpesh qe pasi produkti eshte njohur ne treg dhe ka krijuar imazhin e vet kompania mund te arrije te kete marzhe fitimi bruto me te larta.

- b) *Marzhi i fitimit operativ* eshte raporti i fitimit operativ (fitimi bruto minus shpenzimet e pergjithshme te shitjes dhe shpenzimet administrative) me

SHENIMET E PEDAGOGUT

shitjet. Fitimi operativ quhet ndryshe fitimi perpara interesit dhe taksave (EBIT-Earnings Before Interest and Taxes):

Analistet duhet te shqetesohen nese ky raport eshte shume i ulet. Disa analiste preferojne ta llogarisin marzhin e fitimit operativ duke shtuar shpenzimet e amortizimit dhe zhvleresimit, per te arritur tek fitimet perpara zhvleresimit, interesit, taksave dhe amortizimit (EBDITA).

c) *Marzhi i fitimit neto* eshte raporti i te ardhures neto me shitjet:

Analistet duhet te shqetesohen nese ky raport eshte shume i ulet. Marzhi i fitimit neto duhet te bazohet ne fitimin neto nga operacionet e vazhdueshme, sepse analistet nuk duhet te jene kryesisht te shqetesuar rreth pritjeve te ardhshme dhe zerat "poshte vijes" sic jane operacionet e nderprera te cilat nuk do te ndikojne ne kompani ne te ardhmen

SHTOJCE : SI NJIHEN TE ARDHURAT NE STANDARTET KOMBETARE TE KONTABILITETIT

Me poshte prezantohen metodat kryesore te njohjes se te ardhurave ne ndertim ose ne projektet afat gjata, ne baze te standartit Shqiptar. .Para se te filloje procesi i njohjes se te ardhures duhet te dime qe:

Kur nje kontrate mbulon nje sere sherbimesh ose objektesh per tu ndertuar secili sherbim dhe ndertim objekti duhet trajtuar si nje kontrate afat gjate me vehete kur:

- jane parashtruar propozime te vecanta per cdo sherbim
- cdo sherbim /objekt i eshte neneshtuar negociateve te vecanta dhe kontraktori edhe klienti kane qene ne gjendje te pranojne ose te kundeshtojne ate pejse te kontrates ne lidhje me cdo sherbim / objekt
- kostot dhe te ardhurat per cdo sherbim /objekt mund te identifikohen.

Nje grup kontratesh qofshin keto me nje klient te vetem ose disa kliente duhet te trajtohet si kontrate afat gjate kur ;

- Grupi I kontratave eshte negociuar ne nje pakete te vetme
- Kontratat jane kaq shume te nderlidhura saqe ne te vertete ato jane pjese e nje projekti te vetem me nje marzh fitimi te pergjithshem.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Standartet kontabile kombetare e lidhin njohjen e te ardhures edhe me faktin nese kontrata apo objekti ne ndertim rezulton fitimprures ose jo. Tabela e me poshtme jep nje permbledhje te rregullave kryesore per njohjen e te ardhruave dhe kostove per kotrata aftagjata bazuar ne rezultatet e tyre te pritshme:

Kontratat Fitimprures	Kontatat me Humbje	Kontrata me rezultate te pasigurta
Fitimi njihet kur shuma e te ardhurave mund te percaktohen ne menyre te besueshme	Humbjet e pritshme njohen plotesisht menjehere	Te ardhurat njohen ne te njeten shume si dhe kostot e kryera, si rrjedhim nuk njihet fitim per periudhen ushtrimore
Te ardhurat dhe kostot per periudhen ushtrimore aktuale njohen ne menyre propocionle me raportin e perfundimit te kontraes gje qe rezulton me fitim ne pasqyren te ardhurave dhe shenzimeve		

Shembull 1:

Kompania Tris Shpk ka kontatat e meposhtme ne proces ne 31 dhjetor 2009 (000 000lek)

	Kotnrata A	Kontata B	Kontata C
Data e fillimit te kontrates	1.02.2009	10.01.2009	5.12.2009
Kostot e kryera deri ne 31.12.2009	1,200	800	20
Kostot e perlogaritura deri ne fund te kotrates	3,700	2.400	5,100
Cmimi i kontrates	4,500	4.500	5,500
% e perfundimit	30%	25%	0

Llogarisni shumen e te ardhurave dhe kostot qe do te regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe per kompanine Tris Sh.p.k ne fund te vitit 2009.

Pergjigje :

Po te verejme me kujdes kontata A eshte me humbje pasi cmimi eshte 4,5 bilion lek dhe kosto e pritshme eshte 4.9 bilion lek. Sipas standartit te ardhurat dhe shpenzimet njohen menjere duke realizuar keshtu njohjen e menjehershme te humbjes.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Kontata B rezulton me nje fitim te pritshem keshtu qe te ardhurat do te njihen ne baze te % te kompletimit po keshtu edhe kostot.

Kontata C per shkak te fillimit te vone te saj ajo mbart me vete nje pasiguri ne rezultatet e realizuara ne vitin 2009 per kete arsye dhe te ardhurat dhe shpenzimet njehen ne te njeten mase duke pasur nje fitim te barabarte me 0

Te ardhurat e realizuara nga kontata A	4,500
Te ardhurat e realizuara nga kontata B	$25\% * 4500 = 1,125$
Te ardhurat e realizuara nga kontrata C	20
Te ardhura totale	5,645

Shpenzimet e kryera kontata A	4,900
Shpenzimet e kryera kontrata B	800
Shpenzimet e kryera kontrata C	20
Shpenzime Totale	5,720

Per kontraten A e ardhura e njohur prej 4,500 do te krijoje nje llogari ne Aktive qe mund te quhet Situacion ne proces (natyren e te ciles do ta sqarojme me posht) per 4,500. Kostot qe ne te vertete jane realizuar jane vetem 1200 diferenca prej 3,700 futet tek llogari detyrimesh shpenzime per tu kryer. Arketimet e kyera nga klienti nese ka futen tek nje llogari detyrimesh parapagime te marra ne avance.

Per kontraten B e ardhura e njohur krijon nje llogari aktive Situacione ne Proces 1,125. Shpenzimet e kryera shpenzohen totalisht ne periudhen kontabile, duke krijuar nje fitim prej 325 (000 lek) Cdo arketim i marre ne avance krijon nje llogari detyrime parapagime ne avance .

Per kontraten C e ardhura e njohur krijon nje llogari aktive Situacione ne proces 20,000. Shpenzimet e kryera shpenzohen totalisht ne periudhen kontabile duke krijuar nje fitim te barabarte me 0 . Cdo parapagim nga klienti krijon nje llogari detyrimesh parapagime ne avance. Metoda qe trajtohet kontrata C eshte e ngjajshme me metoden kompletimit te kontrates.

B. PASQYRA E BILANCIT

Pasqyra fillestare per te analizuar pozicionin financiar te nje kompanie eshte bilanci. Kreditoret, investoret dhe analistet duhet te njohin vleren e bilancit dhe kufizimet e tij gjithashtu. Bilanci ju siguron perdoruesve informacion mbi burimet ekonomike te kompanise (aktivet) si dhe mbi burimet financiare te saj (detyrimet dhe kapitalet e veta) Bilanci gjithashtu jep informacion rreth kapaciteteve te fitimeve te ardhshme qe mund te vijne nga aktivet e kompanise nderkohe qe tregon flukset e parase qe mund te vijne ne te ardhmen e afert nga llogarite e arketueshme dhe inventaret.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Megjithate bilanci ka kufizime, kufizime qe lidhen vecanerisht me menyren se si maten aktivet dhe detyrimet. Per ne analizuar bilancin si fillim duhet te njohim komponentet dhe strukturen e tij.

B.1. Komponentet e Bilancit

Sic u tha me lart, bilanci tregon pozicionin financiar te nje kompanie. Pozicioni financiar tregon shumet relative te aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit te vet ne nje moment te caktuar kohe.

Aktivet

Ser David Tweedie Shef i Bordit te IFRS ne nje nga kumtesat e tij para analisteve financiar theksonte “ ***Duhen percaktuar mire aktivet qe te permirsojme pasqyren e te ardhurave***”.

Per te kutuar me mire aktivet duhet te fillojme nga lidhja midis bilancit dhe pasqyres se te ardhurave lidhje e cila mund te shpjegohet nga rrjedhja e kostove ne sitemin e raportimit financiar. Kur nje kompani ka kryer nje kosto, kjo e fundit mund te shpenzohet ose mund kapitalizohet. Nje kosto shpenzohet kur ajo rregjistrohet ne pasqyren e te ardhurave si shpenzim, pra kur ajo sjell te ardhura ose perfitime vetem per periudhen aktuale kontable. Nje kosto kapitalizohet duke u regjistruar si fillim si aktiv ne bilanc, me supozimin se te ardhurat dhe perfitimet do te rrjedhin ne kompani per me shume sesa nje periudhe kontabile. Keto aktive me pas amortizohen dhe dhe transferohet ngadale (ne me shume se nje periudhe kontabile) ne pasqyren e te ardhurave.

Aktivet gjenerohen ose nepermjet blerjes (aktivitetet investuese) ose gjenerohen nepermjet aktiviteve te biznesit (aktivitetet operative). Nepermjet analizes se bilancit, analisti eshte ne gjendje te percatoje se si aktivet financohen. Financimi per blerje te aktiveve afat gjata duhet te vij nga aksioneret dhe /ose nga borxhi afat gjate .

Standartet e raportimit financiar i perkufizojne aktivet si burime te kontrolluara nga kompania qe rrjedhin si rezultat i ngjarjeve te shkuara nga te cilat pritet te rrjedhin perfitimet e ardhshme.

Perkufizimi formal i aktiveve na tregon qe thelbi i tyre qendron ne aftesine per te gjeneruar fitime te ardhshme, dhe si rrjedhim, lexuesi i pasqyrave financiare duke analizuar aktivin shikon mundesine e fitimeve te ardhshme.

Nje perkufizim me i thjeshte i aktiveve eshte konsiderimi i tyre si mbajtes te vleres se kompanise.

Duke u kthyer tek perkufizimi formal i aktiveve kuptoje qe aktivet duhet te njihen si te tilla ne kontabilitet dhe rrjedhimisht ne pasqyrat financiare vetem nese:

- ✓ Ka mundesi qe cdo perfitim i ardhshem ekonomik qe vjen nga nje ze i aktivitetit do te rrjedhe ne kompani.
- ✓ Zeri i aktivitetit ka nje kosto ose vlere qe mund te matet me siguri.

Vlerat qe perfshihen ne aktiv perfshijne edhe:

SHENIMET E PEDAGOGUT

- ✓ shuma qe jane shpenzuar por nuk jane regjistruar si nje shpenzim ne pasqyren e te ardhruave per shkak se ato do te sjellin perfitime edhe ne periudhat e ardhshme kontabile. Nese nje shpenzim i kryer do te sjelle perfitime per me shume se sa nje periudhe kontabel gabimisht ai regjstohet jo si aktiv per si shpenzim i periudhes, ne kete rast shkelet parimi i pershtatjes.
- ✓ ose shumat qe jane raportuar si te fituara ne pasqyren e te ardhurave (per shkak te parimit rrjedhes) por nuk jane arketuar.

Tabela 2 siguron nje liste me te kompletuar te aktiveve qe gjenden ne pasqyren e bilancit.

Tabela 2. Aktivet qe gjithmone perfshihen ne bilanc

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare
Inventaret
Llogari te arketueshme
Shpenzime te parapaguara
Aktive financiare
Taksa te shtyra aktive
Toka, fabrika dhe makineri

Aktive jo te qendrueshme

Te drejta mbi burimet natyrore
Emri i mire

Detyrimet

Detyrimet dhe kapitali i vet perfaqesojne menytrat me te cilat financohen aktivet.

Detyrimet perfkufizohen si sakrificia te mundshme te perfitimeve ekonomike te ardhshme te cilat rrjedhin nga obligimet e tanishme te kompanise. Obligimet e tanishme te kompanise kane lindur si rezultat i ngjarjeve te shkuara dhe e detyrojne kompanine te transferoje aktive ose tu siguroje sherbime kompanive te tjera ne te ardhmen. Nje detyrim pershkruhet si:

- Shumat te arketuara te cilat nuk jane raportuar si nje e ardhur ne pasqyren e te ardhurave dhe do te duhet te njihen ne te ardhmen (ne baze te parimit parimi rrjedhes)
- Shuma qe jane raportuar si shpenzime ne nje pasqyren e te ardhurave por nuk jane paguar (p.sh. llogari per tu paguar, dhe taksa per tu paguar).
-
- Shuma qe jane arketuar dhe do te duhet te ripaguhet ne te ardhmen.

Tabela 3 siguron nje liste me te kompletuar te detyrimeve qe gjenden ne pasqyren e bilancit.

Tabela -3 Detyrimet e perfshira ne pasqyren e bilancit

SHENIMET E PEDAGOGUT

Hua bankare/deftesa per tu paguar
Llogarite e pagueshme
Provigjonet
Te ardhura te pafituara (te marra ne avance)
Detyrime financiare
Detyrime te tjera per tu paguar
Taksa te shtyra pasive

Kapitali i Vet

Kapitali i vet perfaqeson ate pjese qe i perket pronareve ose aksionereve te nje biznesi. Kapitali eshte interesi i mbetur i aktiveve te nje kompanie pasi jane zbritur detyrimet, dhe shpesh i referohemi si vlera e aktiveve neto:

Kapitali = Aktive - Detyrime

Kapitali rritet nga kontributet e pronareve ose nga fitimet e realizuara gjate vitit dhe zvogelohet nga humbjet ose terheqjet ne formen e dividendeve.

Gati cdo aspekt i nje kompanie influencohet ne menyre direkte ose indirekte nga mundesia e sigurimit dhe/ose kostoja e kapitalit te vet.

- 👉 Mjaftueshmeria e kapitalit te vet eshte nje nga faktoret kyc per t'u konsideruar kur vleresohet siguria dhe besueshmeria e nje kompanie te vecante. Nje baze e mjaftueshme kapitali sherben si nje rrjete sigurie kundrejt risqeve te ndryshme ndaj te cilave nje kompani ekspozohet gjate kursit te saj te biznesit.
- 👉 Kapitali i vet siguron nje jastek (amortizator) per te perballuar humbjet e mundshme dhe ne kete menyre siguron bazen e besimit ndaj nje kompanie. Kapitali i vet eshte gjithashtu percaktuesi perfundimtar i kapacitetit te huamarrjes (borxhit) per nje kompani.
- 👉 Kostoja dhe shuma e kapitalit ndikojne ne pozicionin konkurues te kompanise. Per shkak se aksioneret presin nje kthim nga kapitali i tyre, detyrimi per ta fituar kete kthim ndikon ne vendosjen e cmimeve te produkteve te kompanise.
- 👉 Ka dhe nje aspekt tjetër te rendesishem te nivelit te kapitalit, qe lidhet me perspektiven e tregut. Emetimi i obligacioneve kerkon besim publik ne kompani, i cili vendoset dhe mbahet nga kapitali i vet. Ne qofte se nje kompani ka kapital te vet te pamjaftueshem ose ne qofte se kostoja e kapitalit eshte e larte, atehere kompania do te humbase pjese te tregut te vet.

Qellimet kryesore te kapitalit te vet jane qe te siguroje stabilitet dhe te thithe humbjet, duke siguruar keshtu nje mase mbrojtese per kreditoret ne rastin e likuiditimit. Si i tille, kapitali i vet i nje kompanie duhet te kete tre karakteristika kryesore:

- 👉 Ai duhet te jete i qendrueshem.

SHENIMET E PEDAGOGUT

- 🚩 Nuk duhet te imponoje shpenzime fikse te detyrueshme kundrejt fitimeve (si ne rastin e bankave).
- 🚩 Duhet te lejoje perparesi ligjore te drejtave te kreditoreve.

Tabela 4 siguron nje liste te zerave te kapitalit qe perfshihen ne pasqyren e bilancit. Totali i kapitalit te vet ka nje rendesi thelbesore. Gjithashtu e rendeshsime eshte natyra e pronesise se kompanise—identiteti i atyre pronareve qe mund te influencojne ne menyre te drejtperdrejte ne drejtimin strategjik dhe politikat e manaxhimit te riskut te kompanise. Kjo eshte vecanerisht kritike per institucionet financiare, sic jane bankat. Per shembull, struktura e pronesise se nje banke duhet te siguroje integritetin e kapitalit te saj dhe pronaret duhet te jene ne gjendje te sigurojne me shume kapital nese u nevojitet. Kjo eshte arsyeja qe ne shume vende si edhe ne Shqiperi nuk lejohet me ligj nje nje individ te kete paketen kontrolluese te aksioneve ne nje banke.

Tabela 4 Informacioni i kapitalit te vet qe perfshihet ne pasqyren e bilancit

Kapitali i nenshkruar dhe i paguar
Fitime te pashperndara ne kompani

Informacioni qe zakonisht perfshihet per cdo klase te kapitalit ne pasqyren e bilancit ose ne shenimet ne pasqyrat financiare perfshin:

Numri i aksioneve te autorizuar

Numri i aksioneve te emetuara dhe te paguara plotesisht

Numri i aksioneve te emetuara por jo te paguara plotesisht

Vlera nominale per aksion

Bashkerendimi i aksioneve ne fillim dhe ne fund te periudhes raportuese

Te drejtat, preferencat dhe kufizimet e lidhura

Aksionet e kompanise te mbajtura nga kompania, deget ose ortakët

Aksione te rezervuara per emetim sipas opsioneve dhe kontratave te shitjes se aksioneve

B.2. Bazat matese te aktiveve dhe detyrimeve

Lind pyetja: Si matet nje aktiv apo detyrim i paraqitur ne bilanc? Per shembull, nje aktiv mund te jete blere 5 vjet me pare me nje kosto \$1 milion por ka nje vlere aktuale \$5 milion. Ky aktiv do te regjistrohet me koston historike apo me vleren aktuale te tij? Nga njera ane kostoja historike na siguron nje baze matjeje te besueshme dhe te percaktuar sakte dhe askush nuk do te kishte diskutime ne lidhje me koston e aktivitet. Nga ana tjeter, perdoruesit e pasqyrave financiare (p.sh kreditoret) duan te dine se per sa do te shitej aktualisht aktivi nese kompanise do ti duhej te gjente/siguronte mjete monetare.

Disa aktive dhe detyrime mund te vleresohen ne treg me me shume objektivitete sesa disa te tjera kur ekziston nje treg i vendosur ne te cilin aktivitet ose detyrimet

SHENIMET E PEDAGOGUT

tregtohen rregullisht, (sic eshte investimi ne nje kompani tjetere te tregtuar publikisht ose ndryshe i tregtuar ne burse). Per disa aktive apo detyrime te tjera eshte shume e veshtire te gjendet vlera e trgut pasi nuk ka nje treg te vendosur ne te cilin aktivet apo detyrimet te tregtoheshin rregullisht. Per keto aktive / detyrime eshte shume e veshtire te percaktohet vlera e tyre e tregut per kete asye ato mbahen me vleren e tyre historike apo te blerjes.

Si rrjedhim, bilanci sipas standarteve aktuale te kontabilitetit, eshte nje model miksi: disa aktive dhe detyrime raportohen bazuar ne koston historike, ndonjehere me rregullime, nderkohe qe aktive dhe detyrime te tjera maten bazuar ne vleren aktuale te tregut, me qellim prezantimin e vleres se drejte te aktivitetit. Vlera e drejte (fair value) dhe vlera historike mund te perkufizohen si vijon:

- **Vlera e drejte** eshte shuma me te cilen nje aktiv mund te shkembehet ose detyrim mund te shlyhet ne nje trasaksion midis dy paleve te mireformuara dhe te gatshme per kryerjen e transaksionit. Kur aktivet ose detyrimet tregtohen rregullisht, vlerat e tyre e drejte zakonisht mund te percaktohet nga cmimet e tyre te tregut (ndonjehere i referohemi si vlera e drejte e tregut).
- **Kostoja historike.** Kostoja historike e nje aktiviteti ose detyrimi eshte kostoja e tyre ose vlera e brendshme e saj ne momentin e blerjes, duke perfshire cdo kosto te blerjes dhe/ose te pergatitjeve per blerjen.

Ne rrethana te limituara, ndonjehere perdoren baza te tjera matjeje, si kostoja aktuale e zenvedesimit te aktivitetit ose vlera aktuale (vlera aktuale e flukseve te ardhshme te parase e skontuar me koston e kapitalit).

Pyetja kryesore e analisteve eshte se si vlerat e prezantuara ne bilanc te aktiveve dhe detyrimeve lidhen me realitetin ekonomik dhe njera-tjetren. Per ti'u pergjigjur kesaj pyetjeje analisti duhet te kuptoje politikat kontabile te perdorura ne pergatitjen e bilancit dhe bazen e matjes qe eshte perdorur. Per te vleresuar potencialin investues dhe besueshmerine e nje kompanie analistet duhet te bejne rregullime te matjeve te aktiveve dhe detyrimeve te bilancit. Per shembull, toka zakonisht raportohet ne bilanc me koston historike te saj sepse kjo matje eshte objektive dhe cdo matje e vleres aktuale (pervec nje shitjeje aktuale) do te ishte shume subjektive. Nepermjet kerkimeve te kujdesshme nje analist mund te gjejte kompani qe zoterojne toka te vleresueshme qe nuk reflektohen si duhet ne bilanc. Per te gjitha keto arsye, vlera e aktiveve totale te bilancit nuk mund te pranohet si nje matje e kujdesshme e vleres totale te nje kompanie.

Vlera e nje kompanie eshte nje funksion i shume faktoreve, duke perfshire flukset monetare te ardhshme qe priten te gjenerohen nga kompania dhe kushtet aktuale te tregut. Bilanci siguron informacion te rendesishem rreth vleres se disa aktiveve dhe informacion rreth flukseve monetare te ardhshme por nuk paraqet vleren e kompanise si te plote.

Ne menyre qe raportimi financiar te jete i plote dhe te permbush nevojat per informacion te investitoreve, pasqyrat financiare dhe shenimet shoqeruese te tyre

SHENIMET E PEDAGOGUT

duhet te japin informacionin e meposhtem ne lidhje me matjet e perdorura per percaktimin e vlerave te aktiveve dhe detyrimeve te paraqitura ne bilanc:

- Politikat kontabile, duke perfshire formulat e perdorura te kostos.
- Shuma totale e inventareve te mbajtur dhe shumat per kategori.
- Shumat e cdo uljeje ne vlere (write-down) dhe anulimi te uljeve ne vlere.
- Rrethanat ose ngjarjet qe cuan ne ndryshimin (anullimin) e uljeve ne vlere (write-down).
- Inventaret e vendosura si siguri per detyrimet.
- Shumen e inventareve te njohura si nje shpenzim.

Shenimet e pasqyrave financiare dhe diskutimi dhe analiza e manaxhimit jane pjese perberese e proceseve te raportimit financiar te U.S GAAP dhe IFRS. Ato sigurojne shenimet e rendesishme te kerkuara dhe te detajuara, se bashku me informacione te tjera te ofruara ne menyre vullnetare nga manaxhimi.

4.3. Formati i Pasqyres se bilancit

Bilanci siguron informacion rreth pozicionit financiar te kompanise dhe ben dallimin ndermjet kategorive kryesore dhe klasifikimeve kryesore te aktiveve dhe detyrimeve. Detajet dhe formatet e bilanceve variojne nga kompania ne kompani. Megjithate, pavaresisht nga formati, informacioni baze qe perfshihet ne bilanc eshte i njejte.

- Kur perdorim formatin e raportimit, aktivet, detyrimet dhe kapitali i vet listohen ne nje kolone.
- Formati kontabel ndjek skemen e llogarive tradicionale te librit te madh, me aktivet ne te majte dhe detyrimet dhe kapitalin e vet ne te djathte te nje vije ndarese.

Formati i raportimit eshte ai qe zakonisht preferohet me shume dhe qe perdoret nga pergatitesit e pasqyrave financiare. Nese nje kompani do te kishte shume llogari aktive dhe llogari detyrimesh, do behej e veshtire te lexohej bilanci i saj.

- Grupimi se bashku i klasave te ndryshme te aktiveve dhe detyrimeve rezulton ne nje format bilanci te quajtur bilanci i klasifikuar.

Klasifikimi ne kete rast eshte termi i perdorur per te pershkruar grupimin e llogarive ne nenkategori—dhe ndihmon lexuesin qe te kuptoje shpejt pozicionin financiar te kompanise. Klasifikimi mundeson dallimin e shumave specifike dhe grupeve te llogarive gjithashtu.

Klasifikimet me shpesh bejne dallimin midis aktiveve/detyrimeve afatshkurtra (korente) dhe afat gjata (jokorrente), ose kategorive financiare dhe jo financiare—duke mundesuar keshtu sigurimin e informacionit ne lidhje me likuiditetin e ketyre aktiveve ose detyrimeve (ne shume raste ne menyre indirekte).

B.3.1. Dallimi midis konceptit korrent dhe jokorrent

Bilanci duhet te beje dallimin midis aktiveve korrente dhe jokorrente dhe midis detyrimeve korrente dhe jokorrente, megjithese nje prezantim i bazuar ne aftesi

SHENIMET E PEDAGOGUT

likuide do te siguronte nje informacion me te sakte (sic ndodh ne rastin e nje banke ose te nje institucioni financiar te ngjashem).

Nga tabela 5 eshte e qarte qe ne thelb dallimi midis korrent/jokorrent eshte nje perpjekje per te perfshire pritjet e likuiditetit ne strukturen e bilancit. Aktivitet te cilat priten te likuidohen (te kthehen ne para) ose perdoren brenda nje viti ose nje cikli operimi te biznesit, (cilido qofte me i gjate), klasifikohen si aktive korrente. *Cikli operues i nje kompanie eshte sasia e kohes qe kalon midis shpenzimit te mjeteve monetare per te blere inventare dhe pajisje dhe mbledhjes se mjeteve monetare nga ofrimi i te mirave dhe sherbimeve klienteve.*

Shembull:

Cikli i operimit ne aktivitetet e nderitimit te banesave eshte me i gjate se nje vit, pasi qe nga momenti qe shpenzohen parate per ndertimit e baneses deri ne momentin e mbledhjes se mjeteve monetare mund te duhen minimalisht 2 vjet. Ku duhen klasifikuar ne bilanc banesat qe jane duke u ndertuar nga kompania ?

Pergjigje

Ne bilancet e kompanive te ndertimit keto ndertesa do ti gjenin te klasifikuara tek prodhimi ne proces (ose ka kompani te cilat i klasifikojne tek kerkesa te arketueshme) pra ato trajtohen si aktive korrente ose afat shkurtra. Ky klasifikim behet duke u bazuar tek cikli operimit. Praktikisht banesat kane aftesi likujduese te ulet keshtu qe per qellime te analizes se likuiditetit analistet do te duhet te mbeshteteshin tek raporti i shpejte ose prova acide duke perjashtuar nga aktivet korrente llogrine e situacioneve ne proces.

Aktivitet te cilat nuk pritet te likuidohen (te kthehen ne para)ose perdoren brenda nje viti ose nje cikli operues te biznesit, (cilido qofte me i gjate), klasifikohen si aktive jokorrente (afat gjata). Diferenca midis aktiveve korrente dhe detyrimeve korrente quhet kapital punues (kapitali qarkullues). Niveli i kapitalit qarkullues eshte indikator i pare per analistin qe tregon rreth aftesise se nje kompanie per te permbushur detyrimet afatshkurtra. Sidoqofte, kapitali qarkullues nuk duhet te jete shume i madh sepse nje kapital qarkullues i larte tregon per fonde te bllokuara ne aktive afat shkurtra nderkohe qe mund te perdoreshin ne menyre me produktive diku tjeter.

Tabela 5 Bilanci: Dallimi korrente /jokorrente

Korporata Apex	20X7	20X6
Aktivitet		
Aktive korrente	€20,000	€16,000
Aktive jokorrente	53,000	27,000
Aktive totale	€73,000	€43,000
Detyrime dhe kapitali i vet		
Detyrime korrente	14,000	7,000
Detyrime jokorrente	37,000	16,000
Detyrime totale	51,000	23,000

SHENIMET E PEDAGOGUT

Kapitali i vet	22,000	20,000
Totali i detyrimeve dhe kapitalit te vet	€73,000	€43,000

Disa aktive korrente shperndahen ne shpenzime menjehere (p.sh. inventari) pasi ndodhin shitjet, nderkohe qe aktivet jokorrente shperndahen ne pasqyren e te ardhuarve gjate jetes se aktiveve, me ane te amortizimit . Aktivet korrente mbahen per qellime operimi dhe perfaqesojne mjete monetare ose zera qe pritet te konvertohen ne mjete monetare ose te perdoren (p.sh. shpenzime te parapaguara) ne periudhen korrente. Prandaj aktivet korrente na tregojne me shume per aktivitetet e operimit dhe kapacitetin operues te kompanise.

Aktivt jokorrente perfaqesojne infrastrukturen ku kompania operon te cilat nuk konsumohen ose perdoren totalisht ne periudhen korrente. Aktive te tilla perfaqesojne investime potencialisht me pak likuide te bera nga nje perspektive strategjike ose afatgjate (p.sh. per te siguruar avantazhe tregtimi, linja furnizimi, ose sinergji te tjera, sic jane investime ne ortakeri ose investime ne dege).

Nje detyrim korrent eshte nje detyrim qe ploteson te pakten njerin nga kriteret e meposhtme:

- Detyrimi pritet te paguhet brenda nje cikli operues normal te kompanise.
- Detyrimi mbahet kryesisht per qellime tregtimi.
- Ka afat pagese brenda nje viti nga data e pasqyres se bilancit.
- Njesia nuk ka te drejte te pakushtezuar qe te shtyje shlyerjen e detyrimit per me shume se nje vit nga data e pasqyres se bilancit.

Detyrimet financiare klasifikohen si korrente kur kane nje afat pagimi brenda nje viti nga data e pasqyres se bilancit edhe ne rastet kur kushti fillestar i pageses eshte per nje periudhe me te gjate sesa nje vit. Nje rast tipik eshte rasti i pjeses afatshkurter e borxhit afat gjate. Edhe pse nje kredi ne banke eshte marre per 10 vjet, nje kompani do te jete e detyruar te paguaje kestet e nje viti te caktuar. Kesti perbehet nga intersi dhe principalit. Interesat do te transferohen tek pasqyra e te ardhura shpenzimeve ndersa pjesa e principalit qe duhet te paguhet brenda vitit quhet pjesa afatshkurter e borxhit afatgjate, duke u konsideruar sin je detyrim korrent qe duhet paguar Brenda vitit.

Te gjitha detyrimet e tjera klasifikohen si jokorrente. Detyrimet jokorrente perfshijne detyrimet financiare qe sigurojne financime afat gjata. Per kete arsye ato nuk jane pjese e kapitalit qarkullues te perdorur ne ciklin operativ normal te kompanise. Ato nuk kane afat pagimi brenda nje viti nga data e pasqyres se bilancit.

B.4. Klasifimimi i Zerave te Bilancit

B.4.1. Aktivt Korente dhe detyrimet Korente

Aktivt Korente

SHENIMET E PEDAGOGUT

Aktivitet korrente janë aktive që priten të likujdhohen ose të perdoren në ciklin operativ normal të kompanisë. Klasifikohen si aktive korrente të gjitha ato që plotësojnë një nga kushtet e më poshtme:

- *Aktive të mbajtura kryesisht për shitje.*
- *Aktive që priten të likujdhohen brenda 12 muajve nga data e bilancit paraardhës.*

Aktivitet kryesore korrente ose afat shkurtër janë:

- *Mjete monetare ose ekuivalente të mjeteve monetare,*
- *Letra me vlerë të tregtueshme*—borxh ose aksione që zotërohen nga kompania, të cilat janë tregtuar në një treg publik, dhe vlera e të cilave mund të përcaktohet nga cmimi në tregun publik. Shembuj të letrave me vlerë të tregtueshme përfshijnë, bono thesari, deftesa, obligacione, dhe letra me vlerë të kapitalit të vet si, aksionet e zakonshme.
- *Llogari të arketueshme*—shuma të cilat priten të arketohen për produktet dhe shërbimet që janë ofruar por që aktualisht nuk janë arketuar përfshihen tek llogaritë e arketueshme. Një nen ze i kesaj llogari janë edhe dhe provigjonet për borxhin e keq duke reduktuar kështu shumën bruto të llogaritë të akretueshme .
- *Inventaret*—produkte fizike në dispozicion, të cilat mund të ndahen në lende të para, produkte të gatshme dhe produkte gjysem të gatshme.
- *Aktive të tjera korrente*—zera afat shkurtër që nuk klasifikohen në kategoritë e sipërpermendura (p.sh. shpenzime të parapaguara).

Detyrimet korrente

Detyrimet korrente janë ato detyrime që priten të paguheshin në ciklin operativ normal të kompanisë, dhe me afat pagese brenda 12 muajve nga data e pasqyrës së bilancit paraardhës.

- *Llogari të pagueshme.* Llogaritë e pagueshme janë shumat që një biznes u detyrohet furnitoreve të vet për të mirat dhe shërbimet e blera nga ata por që nuk janë paguar akoma.
- *Deftesa për tu paguar.* Deftesat për tu paguar janë shumat që një biznes i detyrohet kreditorëve të vet për shkak të huave të cilat evidentohen nga një marrëveshje huaje (afat shkurtër). Shembuj të deftesave për tu paguar përfshijnë huatë bankare dhe hua të tjera rrjedhese përvet atyre që vijnë nga krediti tregtar. Deftesat për tu paguar mund të shfaqen edhe në seksionin e detyrimeve afat gjatë të pasqyrës së bilancit nëse kanë afat pas një viti ose pas një cikli operues, cilado qoftë me e gjatë.
- *Pjesë afat shkurtër e borxhit afat gjatë.* Me marrëveshje, detyrimet që priten të ripaguheshin ose likuidohen brenda një viti ose cikli operues të biznesit, cilado qoftë me e gjatë, klasifikohen si detyrime korrente. Detyrimet e tjera klasifikohen si jokorrente. Pjesë të borxhit afat gjatë

qe pritet te paguhen brenda vitit ose ciklit operues (pjesa e principalit), konsiderohen si detyrim korent.

- *Takse per tu paguar.* Taksa per tu paguar jane shpenzime taksash qe jane percaktuar dhe regjistruar ne pasqyren e te ardhurave te kompanise por qe nuk jane paguar akoma.
- *Detyrimet rrjedhese.* Detyrimet rrjedhese (te njohura gjithashtu si shpenzimet rrjedhese) jane shpenzime qe jane raportuar ne pasqyren e te ardhurave te kompanise por qe nuk jane paguar akoma sepse nuk ka obligim legal per ti paguar ato brenda dates se pasqyres se bilancit. Shembuj te zakonshem te detyrimeve rrjedhese jane interesi rrjedhes per tu paguar dhe paga rrjedhese per tu paguar.

Te ardhura te pafituara. E ardhura e pafituar (e njohur ndryshe si e ardhura te marra ne avnace) eshte arketimi i parave perpara perfundimit te procesit te perfitimit te te ardhurave. Nje shembull mund te jete , e ardhura e qeraje e marre perpara kohe, arektime nga abonimie apo antaresime afatgjata.

B.4.2. Aktivet Afat Gjata

Aktivitet e Qendrueshme

Aktivitet e qendrueshme jane aktivitet afat gjata me perberje fizike qe perdoren ne operacionet e kompanise, te quajtura ndryshe dhe infrastruktura e kompanise . Keto aktive jo korente paraqiten ne bilanc me koston e tyre historike minus cdo amortizim te akumuluar. Kostoja historike zakonisht perbehet nga kostoja e faturuar nga shitesi , pageses se transportit dhe cdo shpenzim tjeter shtese i bere ne menyre qe aktivi qe aktivi te jete i operueshem. Shembuj te aktiveve te qendrueshme jane toka, ndertesa, pajisje, makineri, mobilje dhe burimet natyrore te zoteruara nga kompania si minierat e bakrit, tokat e naftes dhe gazit, dhe toka pyjore. Nese ndonje nga keto aktive zoterohet por nnuk perdoret ne operacionet e kompanise atehere ato klasifikohen si aktive investuese (rasti i aktiveve te dhena me qira financiare).

Aktivitet jo te qendrueshme

Aktivitet jo te qendrueshme jane aktivitet afat gjata te cilat konsistojne ne shuma te paguara nga nje kompani per te siguruar disa te drejta te cilat nuk perfaqesohen nga zoterimi i nje aktivi fizik. Nje dallim i rendesishem eshte ai qe behet midis aktiveve jo te qendrueshme te identifikueshme dhe aktiveve jo te qendrueshme te pa pa idnetifikueshme. Nje aktiv jo i qendrueshem i identifikuar mund te blihet vecmas dhe lidhet zakonisht me te drejta apo privilegje specifike, Aktivitet e paqendrueshme te idetifikueshme kane nje periudhe perdorimi te percaktuar. Nje aktiv jo i qendrueshem i pa identifikuar nuk mund te blihet vecmas, dhe nuk ka nje periudhe te caktuar perdorimi. Nje shembull i ketij aktivi eshte Emri i Mire.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Kompania duhet të vlersojë, nëse jeta e jetën e aktivitetit jo të qëndrueshëm është e përcaktuar ose jo sepse nga ky fakt varet mënyra sesi ai do të amortizohet.

- Nëse aktiviteti jo i qëndrueshëm ka një jetë përdorimi ai amortizohet në mënyrë sistematike gjatë gjithë jetës së tij.
- Nëse aktiviteti jo i qëndrueshëm ka një jetë të përpërcaktuar atëherë duhet të testohet vlera e tij çdo vit për të përcaktuar vlerën që do të amortizohet përkatesisht çdo vit.

Kompanitë mund të kenë dhe aktive të tjera të paqëndrueshme të cilat nuk futen në bilanc, siç mund të jetë aftësitë menaxheriale, markat e tregëtimit, diferencimi i produktit në treg etj. Këto aktive janë të vlerfshme dhe rrisin vlerën e kompanisë kur kompania shitet.

Gjatë blerjes së kompanisë nëse çmimi i blerjes tejkalon disa harrime mbi vlerën e drejtë të aktiveve neto të blera atëherë krijohet ajo që quhet emri i mirë.

Instrumentat Financiare: Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

Standartet ndërkombëtare të kontabilitetit e perkufizojnë instrumentin financiar si një kontratë që rrit njehkohësisht aktivet financiare të një kompanie dhe detyrimet financiare ose kapitalin e një kompanie tjetër. Instrumentat financiarë, si aktivet edhe detyrimet, vijne në një shumëllojshmëri formash. Aktivet financiare përfshijnë investimet në aksione, obligacione dhe instrumenta të ngjajshëm. Ato mund të klasifikohen si më poshtë ;

Tituj borxhi të mbajtur deri në maturim janë tituj që një kompani ka *qellim dhe aftësi* pozitive për të mbajtur deri në maturim. Këto tituj mbarten me një **costo të amortizuar** dhe nuk mund të shiten para maturimit, përveç rrethanave të pazakonshme. Ky klasifikim zbatohet vetëm në titujt e borxhit; nuk zbatohet në investimet e kapitalit të vet.

Titujt e borxhit dhe të kapitalit të vet në dispozicion për shitje mund të shiten për të plotësuar nevojat për likuiditete dhe nevoja të tjera të një kompanie.

Titujt e borxhit dhe të kapitalit të vet të klasifikuar në dispozicion për shitje mbarten në pasqyrën e bilancit me vlerën e drejtë të tregut. Të gjitha të ardhurat nga interesat, dividendet dhe fitimet ose humbjet e realizuara raportohen në pasqyrën e të ardhurave. Fitimet dhe humbjet e përealizuara përjashtohen nga fitimi por raportohen si një komponent i vecantë i kapitalit të aksionereve .

Titujt të tregtueshëm të borxhit dhe kapitali të vet janë tituj të blerë me qëllim shitjen e tyre në një afat të shkurtër. Këto tituj maten me vlerën e drejtë të tregut dhe në pasqyrën e bilancit listohen si aktive korrente. Fitimet dhe humbjet e përealizuara dhe të realizuara si dhe të ardhurat nga interesat dhe dividendet raportohen në pasqyrën e të ardhurave.

SHENIMET E PEDAGOGUT

Detyrimet financiare perfshijne obligacionet, deftesa per tu paguar dhe instrumenta te ngjajshem.

Ka disa instrumenta financiare te cilet mund te klasifikohen si nje aktiv ose detyrim, ne varesi te kushteve te kontrates dhe kushteve korrente te tregut. Nje shembull i nje aktivi financiar kaq kompleks eshte nje leter me vlere derivative.

Nje leter me vlere derivative eshte nje instrument financiar vlera e te cilet bazohet ne nje faktor te percaktuar (norma e interesit, kursi i kembimit, cmimi i aksionit etj) dhe per te cilat nuk kerkohet ose kerkohet shume pak investim fillestar. Letrat me vlere derivative perdoren por te mbrojtur biznesin nga risku sistematik dhe per qellime spekulimi.

Kapitali i Vet

Kapitali i vet eshte pretendimi i mbetur mbi aktivet e kompanise pasi jane zbritur detyrimet. Ai perfaqeson pretendimin qe ka pronari ne kompani. Kapitali i vet perfshin fondet qe pronaret kane investuar drejtpersedrejti ne kompani, bashke me fitimet qe jane riinvestuar ne kohe ndryshe te quajtura fitimet e pashperndare . Kapitali i vet perfshin edhe zera te fitimeve po humbjeve te cilat nuk kane kaluar nepermjet pasqyres se te ardhurave. Ne kete pjese mund te futet fitimet apo humbjet qe qe perfshihen nga konvertimi i pasqyrave financiare nga nje monedhe ne nje monedhe tjeter, apo humbjet apo fitimet e parealizuara nga letrat me vlere disponibel per shtitje.

Komponentet e kapitalit te vet

IFRS dhe U.S GAAP e perkufizojne kapitalin e vet (ose aktivet neto) si interesi i mbetur ne aktivet e kompanise pasi i jane zbritur detyrimet e saj. Jane 5 komponente potenciale qe perfshihen ne seksionin e kapitalit te vet ne pasqyren e bilancit:

1. Kapitali i kontribuar nga aksioneret. Zoterimi i nje kapitali ne nje kompani evidentohet nepermjet emetimit te aksioneve te zakonshme, meqenese aksionet preferenciale (nje leter me vlere hibride me disa karakteristika te borxhit) mund te emetohen nga disa kompani vec aksioneve te zakonshme. Aksionet e preferuara kane te drejta qe kane prioritet mbi te drejtat e aksionereve te zankoshem—te drejta qe zakonisht lidhen me pagesen e dividendeve dhe shlyerjen e aksioneve nese kompania eshte duke u likuiduar. Aksionet e zakonshme dhe te preferuara kane nje vlere nominale (ose vlere te shpallur), ose emetohen si aksione pa vlere nominale. Kur ekzistojne kerkesa te vleres nominale, ato duhet te perfshihen ne seksionin e kapitalit te vet te bilancit. Gjithashtu numri i aksioneve te autorizuara te emetuara si dhe numri i aksioneve ne qarkullim duhet te behet i ditur per cdo klase aksionesh te emetuara nga kompania. Numri i aksioneve te autorizuara eshte numri i aksioneve qe mund te shiten nga kompania bazuar

SHENIMET E PEDAGOGUT

ne statutin e asaj te formimit. Numri i akisoneve te emetuara eshte numri i aksioneve te shtitura aksionereve. Numri i aksioneve qe jane ne qarkullim perbehet nga aksionet e emetuara minus ato aksione te riblera nga kompania (aksione thesari).

2. Interesat e minoritetit (ose interesi i paketave jokontrolluese). Interesat e minoritetit perfaqojne pjesen e nje filiali te konsoliduar qe nuk zoterohet i gjithi nga mema por edhe nga kompani te tjera. Per shembull, nese nje kompani zoterohet 85 % nga mema, 100% e aseteve te saj konsolidohet me memen. Interesi i minoritetit perfaqson 15% te aseteve neto qe nuk zoterohen nga kompania meme.

3. Fitimet e pashperndara perfaqesojne shumat qe jane njohur si fitime ne pasqyrat e te ardhurave te kompanise por qe nuk u jane paguar pronareve te kompanise nepermjet dividendeve, duke u riinvestuar si pjese e kapitalit te vet.

4. Aksione thesari (ose riblerje e aksioneve te veta). Shpesh here kompanite mund te riblerjne ne burse aksionet e tyre. Riblerja e aksioneve te kompanise ndodh kur manaxhimi i konsideron aksionet te nenvleresuara ose kur do te kufizoje efektet e dobesimit te fitimit per aksion.

B.5. Perdorimet dhe Analiza e Bilancit

Seksionet e klasifikuara te bilancit te Apex Corporation jane diskutuar dhe ilustruar gjate te gjithe kapitullit. Tabela 5-1 paraqet bilancin e plote dhe te detajuar te Apex te cilin ne do ta perdorim si baze per diskutim se si te analizojme nje bilanc.

Tabela 5-1

Bilanci (000)	20X7	20X6
Aktivet		
Aktive korrente	€20,000	€16,000
Mjete monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare	3,000	2,000
Letra me vlere te tregetueshme	3,000	4,000
Llogari te arketueshme	5,000	3,000
Inventare	7,000	6,000
Aktive te tjera korrente—shpenzime te parapaguara	2,000	1,000
Aktive jokorrente	53,000	27,000
Toka, fabrika dhe makineri	35,000	20,000
Emri i mire	5,000	1,000
Aktive te tjera	3,000	1,000
Investime jokorrente	10,000	5,000
Aktive totale	€73,000	€43,000

SHENIMET E PEDAGOGUT

Detyrimet korrente dhe kapitali i vet		
Detyrime korrente	€14,000	€7,000
Llogari per tu paguar	5,000	2,000
Deftesa per tu paguar	3,000	1,000
Pjese korrente e huave jokorrente	2,000	1,000
Takse korrente per tu paguar	2,000	2,000
Detyrime rrjedhese	1,000	500
E ardhur e pafituar	1,000	500
Detyrimet jokorrente	37,000	16,000
Hua jokorrente	30,000	10,000
Taksa te shtyra	6,000	5,000
Provigjione jokorrente	1,000	1,000
Detyrime totale	51,000	23,000
Kapitali i vet	22,000	20,000
Kapital aksionesh	10,000	10,000
Aksione preferenziale	2,000	2,000
Prim aksionesh (te paguara ne kapital)		
Fitime apo humbje te perealizuara	1,000	
Fitime te pashperndara	9,000	8,000
Aksione te vetat re riblera (aksione thesari)		
Totali i detyrimeve dhe kapitali i aksionereve	€73,000	€43,000

Nese nje kompani po rritet apo po zvogelohet, krahasimi i vlerave absolute te bilancit nga viti ne vit nuk i tregon qarte trenden e saj. Si rrjedhim, krahasimi i kompanive eshte i veshtire . Dy teknikat e perdorura per te analizuar bilancet jane

- ✓ Analiza e matjes se thjeshte dhe
- ✓ Analiza e raporteve financiare

Meqe me analizen e raporteve financiare do te ndalojme ne nje kapitull te vencate ketu do te paraqesim vetem analizen e matjes se thjeshte.

B.5.1. Analiza e matjes se thjeshte e bilancit

Teknika e pare e analizes , eshte analiza e matjes se thjeshte, e cila perfshin kthimin e te gjitha zerave te bilancit si nje perqindje e aktiveve totale. Pasqyrat e matjes se thjeshte perdoren per te krahasuar bilancin aktual te kompanise me bilancet e viteve te meparshme ose me kompani te tjera ne te njejten industri.

Tabela 5-1.2

Bilanci (000)	20X7	20X6
Aktivet		
Aktive korrente	24,7	37,2
Mjete monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare	4,1	4,7
Letra me vlere te tregetueshme	4,1	9,3

SHENIMET E PEDAGOGUT

Llogari te arketushme	6.8	7.0
Inventare	9.6	14
Aktive te tjera korrente—shpenzime te parapaguara	2.7	3.2
Aktive jokorrente	72,6	62,8
Toka, fabrika dhe makineri	47,9	46,5
Emri i mire	6,8	2,3
Aktive te tjera jomonetare	4,1	2,3
Investime jokorrente	13,7	11,6
Aktive totale	100%	100%
Detyrimet korrente dhe kapitali i vet		
Detyrime korrente	19.2	16.3
Llogari per tu paguar	6.8	4.7
Deftesa per tu paguar	4.1	2.3
Pjese korrente e huave jokorrente	2,7	2,3
Takse korrente per tu paguar	2,7	4,7
Detyrime rrjedhese	1,4	1,2
E ardhur e pafituar	1,4	1,2
Detyrimet jokorrente	50.7	37.2
Hua jokorrente	41.1	23.3
Taksa te shtyra	8,2	11,6
Provigjione jokorrente	1.4	2.3
Detyrime totale	69.9	53,5
Kapitali i vet	30,1	46,5
Kapital aksionesh	13,7	23,3
Aksione preferenziale	2,7	4,7
Prim aksionesh (te paguara ne kapital)		
Rezerva te tjera (fitime apo humbje te perealizuara)	1,4	
Fitime te pashperndara	12.3	18.7
Aksione te vetat re riblera (aksione thesari)		
Totali i detyrimeve dhe kapitali i aksionereve	100%	100%

Nga analiza e matjes se thjeshte (tablela 5.1.2) shikohet se ne vitin 20x7 kompania eshte me pak likuide si dhe ka perdorur me shume borxh sesa ne vitin 20x6. Persa i perket likuiditetit aktivet korrente kane rrene dhe detyrimet korrente jane rritur kur krahasohet me nje vit me pare. Si rrjedhim kemi nje ulje te kapitalit punues. Nese do te analizonim ze per ze uljen e aktiveve korrente prej 11% kjo ulje ka ardhur si rezultat i uljes se elemeteve me likuid (renditur sipas aftesise likujduese)

mjete monetare +letra me vlere te tregetueshme + llogari te arktueshme	6%
Inventarit	4.4%
Shpenzime te parapaguara	0.6%

SHENIMET E PEDAGOGUT

Per sa i perket perdorimit te borxhit te dy elemetet edhe detyrimet korrente dhe detyrimet jokorrente jane rritur krahasur me nje vite me pare . Verehet nje rritje e borxhit afat gjate me 13.8% nje rritjee e detyrimit afat shkurter me 2.9%.

Rritja e borxhit eshte shoqeruar tanime me nje zvogelim financimit me ane te kapitalit te vet gje qe con ne rritjen e riskut financiar per kompanine.

Shikojme nje rritje ne emrin e mire (e cila mund te kete ardhur si rezultat i blerjes se ndonje kompanie tjeter me cmim me te larte se vlera e drejte e aktiveve neto)

Analiza e matjes se thjeshte vertikale e bilancit eshte vecanerisht e perdorshme ne analizen *BRENDA SEKTORIT*, duke i krahasuar kompanite me njera-tjetren per nje peridhe kohe te vecante, ose duke krahasuar kompanine me industrine ose te dhena te sektorit.

Kur analizojne nje kompani shume analiste preferojne te zgjedhin kompani te barabarta per krahasim ose te perpilojne statistikat e tyre te industrise.

Megjithate situata e plote financiare nuk mund te jepet vetem me rezultatet qe dalin nga analiza e matjes se thjeste te bilancit. Kete te dhena duhet te plotesohen me rezultatet qe dalin nga analiza e raporteve financiare si dhe nga analiza e pasqyres se te ardhurave dhe pasqyres se flukseve te parase